



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.230/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MC Catering” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF - 53217-03-06-2020 me objekt Loti 1 “*Blerje bukë gruri dhe simite*” me fond limit 6.440.906 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 17.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** “MC Catering” shpk  
Rruga Pjetër Budi, Nd.29, H.3, Ap.14, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Sheshi Skënderbej, Nr,3, Tiranë,

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e*

rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.03.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF -53217-03-06-2020 me objekt Loti 1 “*Blerje bukë gruri dhe simite*” me fond limit 6.440.906 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 17.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 17.04.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 01.05.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- In-Ma	pa ofertë	I skualifikuar
- Gerti 1987	pa ofertë	I skualifikuar
- Nelsa	pa ofertë	I skualifikuar
- MC Catering	4,254,340	I skualifikuar
- 4S	5,044,150	I kualifikuar
- Nika	5,610,600	I skualifikuar
- Dajti Park 2007	6,009,300	I kualifikuar

II.4. Në datën 01.05.2020 operatori ekonomik “MC Catering” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2 të Kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomike, pasi nuk arriti të paraqesë, Leje Mjedisit të tipit C (kodi III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar).*
- *Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të Kapacitetit teknik, pasi nuk arriti të vertetojë se ka në pronësi ose në përdorim 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m2. Kontrata e furnizimit me nr. Repertori; 433, nr.koleksioni 96 e datës 20/03/2020 e lidhur me subjektin “Eraldo - 2013” shpk, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm midis ofertuesit “M.C Catering” SHPK dhe “Erald - 2013” shpk nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Erald - 2013” shpk dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK.*
- *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklarata të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.*

II.5. Në datën 07.05.2020 operatori ekonomik ankimues “MC Catering” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në lidhje me këtë pretendim ju sqarojmë se në DT për këtë procedurë kriteret e vecanta të kualifikimit 2.1 operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë : *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, për prodhimin ose tregtimin e bukës, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*
- *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar). Në përmbushje të këtij kriteri kemi paraqitur Licencën e kategorisë II.1A në emër të shoqërisë MC Catering shpk e cila plotëson kriterin 1, licencë e cila është specifikuar të jetë në emër të vetë operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe jo të një operatori tjetër.*
- *Në dokumentat e paraqitur elektronikisht për këtë procedurë kemi paraqitur Kontratën e Furnizimit Nr.433 Rep, Nr.96 Kol datë 20.03.2020 me shoqërinë Eraldo 2013 shpk kjo e fundit prodhues brumrash e cila disponon të gjithë dokumentacionin ligjor për ushtrimin e këtij aktiviteti (QKL II.1.A si dhe QKL III.1.A) e cila plotëson katërcipërisht kriterin 2 të vendosur nga ju, në asnjë paragraf të kërkesave për kualifikim nuk është përcaktuar që kjo Licencë duhet të jetë vetëm në emër të operatorit ekonomik dhe jo të një operatori tjetër, dhe për më tepër Leje Mjedisi tipi C (QKL III.1.A) jepet për furrat e bukës , subjektet prodhuese dhe jo për operatorët ekonomikë joprodhues. Nuk e kuptojmë se cilën pikë të këtij kriteri nuk plotësojmë, kur kemi paraqitur të 2 licencat e kërkuara sipas specifikave të dhëna nga ju si AK dhe KVO të na sqarojë se ku është kërkuar Leje Mjedisi e tipit C në emër të operatorit ekonomik. Referuar rekomandimit të APP nr.10181 datë 19.11.20218 në asnjë moment nuk citohet disponimi i QKL-ve të tjera në emër të operatorit, por njihen të gjitha format e bashkëpunimit me operatorët prodhues të cilët garantojnë furnizimin me artikuj ushqimorë , kapacitete teknike të fituara, nga eksperiencia shumë vjecare në furnizimin me artikuj ushqimore të shumë institucioneve shtetërore ndër vite. Shoqëria MC Catering disponon QKL II.1.A në emër të saj si dhe të gjitha kapacitetet e tjera teknike për furnizimin me artikuj ushqimorë kapacitete teknike të fituara nga eksperiencia shumë vjecare në furnizimin me artikuj ushqimorë të shumë institucioneve shtetërore ndër vite.*

*Sa më sipër pretendimi i KVO për skualifikim nuk qëndron.*

- *Në DT për këtë procedurë konkretisht Loti 1 Blerje bukë gruri dhe sime kapaciteti teknik pika 1.3 është kërkuar:*
- *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m<sup>2</sup>, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*
- *Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:*

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
- Kontratë noteriale huapërdorje.
- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
- Kontratë noteriale qiraje.
- Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
- Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë ambient.
- Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi.

*Për përmbushjen e këtij kriteri kemi paraqitur Kontratën e Furnizimit me shoqërinë Eraldo-2013 shpk e cila disponon furrë buke bashkëlidhur i gjithë dokumentacioni i kërkuar në DT. Kontrata e furnizimit është e garantuar sipas neneve 772-783 të Kodit Civil si dhe nenet 62,99,100,101 e vijues në ligjit 110/2018 datë 20.12.2008 Për noterinë të cilat garantojnë AK për përmbushjen me sukses të realizimit të kontratës në rast shpallje fitues.*

*I gjithë dokumentacioni i paraqitur në përmbushje të këtij kriteri përmbush pikërisht kriterin e vendosur në DT kapaciteti teknik pika 1.3 , nuk ka sesi të jetë në emër të shoqërisë për sa kohë ky ambient nuk është në pronësi të shoqërisë. Me këtë arsyezim të bërë nga KVO ambienti duhet domosdoshmërisht të jetë në pronësi të OE prodhues gjë e cila kufizon në maksimum konkurrencën duke shkelur LPP neni 20 mosdiskriminimi.*

*Për sa kohë këto kontrata sigurojnë furnizim të insitucionit tuaj me sukses të kontratës në rast shpallje fitues përse domosdoshmërisht këto ambiente u dashkan në pronësi dhe pse diskriminohen nga KVO juaj operatorë serioz në treg si MC Catering me eksperiencë shumëvjeçare në furnizimin e institucioneve shtetërore në cdo cep të shqipërisë shoqëri me kapacitete teknike maksimale si fuqi punëtore , mjete, licenca, kontratat të ngjashme, xhiro në kapacitetet të larta shoqëri e cila jep siguri maksimale në cdo kapacitet për realizimin me sukses të kontratës.*

- Në DT është përcaktuar: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të

veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 2, 3 dhe 4 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Nuk e kuptojmë se çfarë ndarje duhet ti bëjmë institucionit tuaj për kriteret të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Kur vërtetimi i xhiros i marrë enkas për këtë lot për tre vite e tejkalon disa herë atë të kërkuar për të gjitha lotet e kësaj procedure . Kontrata e ngjashme të paraqitura janë të shoqëruar me vërtetim të cilat janë të ndara sipas loteve të kërkuara dhe jo në total të cilat do të kërkonin ndarjen e vlerave sipas artikujve të cdo loti përkatës (asnjë kontratë furnizimi e paraqitur si kontratë e ngjashme nuk ka në objekt të saj artikuj ushqimorë të përzier por janë të ndarë sipas loteve të kësaj procedure , konkretisht kemi paraqitur kontratë me QEZHEF me objekt Blerje bukë gruri, Blerje bukë thekre dhe integrale, të cilat tejkalojnë vlerën e kërkuar nga ju në përmbushje të kontratës së ngjashme).

Mjetet e kërkuara për 4 lote ku kemi marrë pjesë (Bukë+Mish+Koloniale+fruta perime) është 7 dhe ne kemi paraqitur dokumentacionin e rregullt për disponimin e 7 mjeteve konkretisht 4 makina ATP dhe 3 makina ATV sipas specifikave të kërkuara në DT . Numri mesatar i punëtorëve i kërkuar në 4 lote ku kemi marrë pjesë (buke, mish, koloniale, fruta perime), është 14 punëtorë dhe ne kemi provuar nëpërmjet vërtetimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe listpagesave se disponojmë 15.3 punëtorë mesatarisht për periudhën Dhjetor 2019-Shkurt 2020 të kërkuar në DT.....

Ambjenti i paraqitur për këtë procedurë është paraqitur vetëm për këtë lot dhe në asnjë lot tjetër.

Për sa kohë kriteret e kërkuara në mënyrë kumulative nga institucioni juaj janë plotësuar vecmas për cdo lot respektiv nga ana e shoqërisë MC Catering shpk dhe për sa kohë jo vetëm i plotësojmë por i kalojmë disafish ato nuk qëndron ky pretendim i KVO.

Për sa më lart pretendimi i KVO për skualifikim nuk qëndron

II.6. Në datën 14.05.2020 me shkresën nr. 709/3 prot operatori ekonomik ankimues “MC Catering” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 22.05.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.913/3 prot datë 01.06.2020 protokolluar me tonën me nr.456 prot datë 05.06.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2 të Kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomike, pasi nuk arriti të paraqesë, **Leje Mjedisit të tipit C (kodi III.1.A)**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar)”, si dhe Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të Kapacitetit teknik, pasi nuk arriti të vertetojë se ka në pronësi ose në përdorim 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m<sup>2</sup>. Kontrata e furnizimit me nr. Repertori; 433, nr.koleksioni 96 e datës 20/03/2020 e lidhur me subjektin “Eraldo - 2013” shpk, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm midis ofertuesit “M.C Catering” SHPK dhe “Erald - 2013” shpk nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Erald - 2013” shpk dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.1.2 “Kapaciteti ligjor/prefesional i operatorëve ekonomikë”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **Leje Mjedisit të tipit C (kodi III.1.A)**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar).

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.2.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m<sup>2</sup>, për të cilin duhet të paraqes dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

- a) Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:
  - Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
    - Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
  - Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
    - Kontratë noteriale huapërdorje.
  - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
    - Kontratë noteriale qiraje.
- b) Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
- c) Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
- d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë ambient.
- e) Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Furnizimi Nr.433 Nr.96 Kol datë 20.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Eraldo 2013 në cilësinë e furnizuesit dhe MC Catering shpk pranuesi i furnizimit me objekt: *Furnizimi me bukë të bardhë, bukë të zezë, bukë thekre dhe bukë integrale.*
- Licencë me Kod II.1.A subjektit Eraldo – 2013 “*Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Prodhim buke)*” lëshuar nga QKB.
- Leje Mjedisi e tipit C me Kod III.1.A subjektit Eraldo – 2013 për fura të prodhimit të bukës, lëshuar nga QKB
- Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.456 datë 06.03.2014
- Certifikatë për kryerjen e shërbimit 3D
- Deklaratë Magazina plotëson të gjitha standartet tekniko teknologjike
- Certifikatë Nr. 12459/1 prot datë 15.04.2020 Për mbrojtjen nga zjari dhe shpëtimin
- Foto

III.1.4. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se është kërkuar shprehimisht se: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Leje Mjedisi të tipit C (kodi III.1.A), të lëshuar



nga Qendra Kombëtare e Biznesit (sipas ligjit nr.60/2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar).

Gjithashtu në kriteret e vecanta të kualifikimit kërkohet se: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m<sup>2</sup>, për të cilin duhet të paraqes dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

Kontratë noteriale huapërdorje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

Kontratë noteriale qiraje.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton se ky i fundit në përmbushje të këtij kriterëve ka paraqitur Kontratë Furnizimi Nr.433 Nr.96 Kol datë 20.03.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Eraldo 2013 në cilësinë e furnizuesit dhe MC Catering shpk pranuesi i furnizimit me objekt: *Furnizimi me bukë të bardhë, bukë të zezë, bukë thekre dhe bukë integrale*. Licencë me Kod II.1.A subjektit Eraldo – 2013 “*Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Prodhim buke)*” lëshuar nga QKB. Leje Mjedisi e tipit C me Kod III.1.A subjektit Eraldo – 2013 për fura të prodhimit të bukës, lëshuar nga QKB. Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.456 datë 06.03.2014 Certifikatë për kryerjen e shërbimit 3D. Deklaratë Magazina plotëson të gjitha standartet tekniko teknologjike. Certifikatë Nr. 12459/1 prot datë 15.04.2020 Për mbrojtjen nga zjari dhe shpëtimin .Foto të ambienteve të furës së bukës

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e kriterit të vecantë të kualifikimit nuk është në përputhje me përcaktimet në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi për shkak se në kriter është kërkuar që ambjenti prej 50 m<sup>2</sup> për magazinimin e mallrave duhet të disponohet në dy forma ligjore atë të pronësisë dhe atë të përdorimit. Përdorimi në rastin konkret është specifikuar të jetë nëpërmjet qerasë ose huapërdorjes Konkretisht me dokumentacionin e dorëzuar në SPE për ambjentin e magazinimit ankimuesi pretendon se e disponon atë nëpërmjet kontratës së furnizimit të sipërcituar me subjektin Eraldo 2013. KPP gjykon se kontrata e furnizimit nuk është dokumentacion i kërkuar në kriterin e kualifikimit pasi në kriter kërkohet shprehimisht ambjenti duhet të jetë në pronësi, me kontratë qeraje apo huapërdorjeje. Për më tepër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit KPP vëren se mungon dokumentacioni i kërkuar në kriter konkretisht Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe mungojnë gjithashtu të dhënat në lidhje me sipërfaqen e kërkuar.

Akoma më tej ankimuesi nuk provon se disponon leje mjedisore të tipit C me kod III.1.A pasi leja mjedisore e dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike nga ankimuesi i përket subjektit Eraldo 2013 shpk dhe jo operatorit ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi sikundër kërkohet në kriterin e kualifikimit.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa*

*identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” sh.p.k nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 2, 3 dhe 4 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “MC Catering” shpk ka marrë pjesë në tre lote të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterëve kualifikuese rezulton se operatori ekonomik ankimues “MC Catering” shpk nuk ka dorëzuar një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret, në rastin kur merr pjesë në më shumë se një lot.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e*

tenderit...”

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.5. Referuar edhe parashtimeve në ankesë ankimeusi pranon mungesën e deklaratës me arsyetimin se *Nuk e kuptojmë se çfarë ndarje duhet ti bëjmë institucionit tuaj për kriteret të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Kur vërtetimi i xhiros i marrë enkas për këtë lot për tre vite e tejkalon disa herë atë të kërkuar për të gjitha lotet e kësaj procedure. Kontrata e ngjashme të paraqitura janë të shoqëruar me vërtetim të cilat janë të ndara sipas loteve të kërkuara dhe jo në total të cilat do të kërkonin ndarjen e vlerave sipas artikujve të cdo loti përkatës (asnjë kontratë furnizimi e paraqitur si kontratë e ngjashme nuk ka në objekt të saj artikuj ushqimorë të përzier por janë të ndarë sipas loteve të kësaj procedure, konkretisht kemi paraqitur kontratë me QEZHEF me objekt Blerje artikuj ushqimorë (koloniale) të cilat tejkalojnë vlerën e kërkuar nga ju në përmbushje të kontratës së ngjashme). Mjetet e kërkuara për 4 lote ku kemi marrë pjesë (Bukë+Mish+Koloniale+fruta perime) është 7 dhe ne kemi paraqitur dokumentacionin e rregullt për disponimin e 7 mjeteve konkretisht 4 makina ATP dhe 3 makina ATV sipas specifikave të kërkuara në DT. Numri mesatar i punëtorëve i kërkuar në 4 lote ku kemi marrë pjesë (buke, mish, koloniale, fruta perime), është 14 punëtorë dhe ne kemi provuar nëpërmjet vërtetimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe listpagesave se disponojmë 15.3 punëtorë mesatarisht për periudhën Dhjetor 2019-Shkurt 2020 të kërkuar në DT.....*

*Ambjenti i paraqitur për këtë procedurë në total sipërfaqe 354.7 m<sup>2</sup> (Sipërfaqe e deklaruar nga ana jonë në total është 1204.7 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e kërkuar për të tre lotet së bashku mish+koloniale+perime, sipërfaqja e kërkuar është 250 m<sup>2</sup>, në total 954.7 m<sup>2</sup> sipërfaqe më tepër e deklarur se ajo e kërkuar. Për sa kohë kriteret e kërkuara në mënyrë kumulative nga institucioni juaj janë plotësuar vecmas për cdo lot respektiv nga ana e shoqërisë MC Catering shpk dhe për sa kohë jo vetëm i plotësojmë por i kalojmë disafish ato nuk qëndron ky pretendim i KVO.*

III.2.6. KPP gjykon se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e

dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF -53217-03-06-2020 me objekt Loti 1 “*Blerje bukë gruri dhe simite*” me fond limit 6.440.906 lekë pa tvsh zhvilluar në datën 17.04.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 458 Protokolli; Datë 22.05.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**